



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Qemajl Aliu , Kryetar i Komunës së Shtimes Rrahman Jakupi , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	<i>pec</i> Elbert Krasniqi , Ministër i MAPL-së Jeton Qela , Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erbllin Hetemi , Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 09.01.2026 Nr.020-15
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit Sanije Dërguti , Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Shtimes	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e kuvendit të komunës në vijim:

Vendimi Npi-01/02 për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Z. Rrahman Jakupi
I miratuar më datë: 03.01.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08.01.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjisllacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur me datë 03.01.2026, ka miratuar Vendimin Npi-01/02 për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Z. Rrahman Jakupi.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, është bazuar në nenin 12 dhe nenin 41 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Komunave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 e datës 04 Qershor 2008), në Udhëzimin Administrativ 2009/01 MAPL për procedurat e zgjedhjes dhe përgjegjësit e Kryesuesit të Kuvendit, me të cilin vendim është zgjedhur Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes.

Vendimi Npi-01/02 për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Z. Rrahman Jakupi, është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Shtimes me datë 03.01.2026, me 12 vota "për", 9 "kundër" dhe 0 "abstenim".

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Qemajl Aliu, gradonačelnik opštine Štimlje Rrahman Jakupi, prededavajući Skupštine opštine Štimlje
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a,
Od:	Erblin Hetemi, direktor Pravnog odeljenja i monitorisanje opština / MALS
Odgovorni službenici:	
1.Službenik/ca za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za razmatranje zakonitosti akata opštine i gradonačelnika
2.Službenik/ca za izradu pravne ocene	Sanije Dërguti, viša službenica za razmatranje zakonitosti opštinskih akata
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Štimlje
Vrsta odluke:	Odluka Skupštine opštine

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka Npi-01/02 o izboru predsedavajućeg Skupštine opštine Štimlje g. Rrahman Jakupi
Usvojena dana, 03.01.2026.
Podnešena na razmatranje u MALS-u dana, 08.01.2026.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Štimlje, na sednici održanoj dana, 03.01.2026. godine, usvojila je Odluku Npi-01/02 o izboru predsedavajućeg Skupštine opštine Štimlje g. Rrahman Jakupi.

MALS, konstatuje da je odluka doneta od strane Skupštine opštine Štimlje, zasnovana na članu 12 i članu 41, Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi (Službeni list Republike Kosovo br. 28 od dana, 04. juna 2008. godine), na Administrativnom uputstvu br. 2009/01 MALS o procedurama izbora i odgovornosti predsedavajućeg Skupštine opštine, odlukom kojom je izabran predsedavajući Skupštine opštine Štimlje.

Odluka Npi-01/02 o izboru predsedavajućeg Skupštine opštine Štimlje g. Rrahman Jakupi, usvojena je na sednici Skupštine opštine Štimlje dana, 03.01.2026. godine, sa 12 glasa "za 9 "protiv" i 0 "uzdržanih".

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY
SHTIME / ŠTIMLJE
Nr.01-060/01-31936/25, datë:26.12.2025

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING		
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO OPŠTINA E KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVA / MUNICIPALITY OF KOSOVO		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministritsi i Lokalit / Samoprava i Administracije Ministry of Local Government Administration		
Data: Datum:	08.01.2026	
Tipi i regjistrimit:	Mr. i Lendës	Vota
-U/-	420-15	

Npi - 01/02 datë: 03.01.2026

Në bazë të nenit 12 dhe 41 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Udhëzimi Administrativ të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal Nr.2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, si dhe pas shpalljes së rezultateve të numëruara të votave të mshefta për zgjedhjen e Kryesuesit nga Komisioni Votues, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në vazhdimin e mbledhjes së Jashtëzakonshme, të mbajtur më 03.01.2026, miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
RRAHMAN JAKUPI**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në vazhdimin e mbledhjes së Jashtëzakonshme, të mbajtur më datën 03.01.2026, (bazuar në votat e numruara nga Komisioni Votues) me 12 vota "Për", me 9 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" miratoi Vendimin për zgjedhjen e z.Rrahman Jakupi - Shtime, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes.

II

Për Kryesues të Kuvendit të Komunës së Shtimes, anëtarët e Kuvendit i propozuan dy kandidat: Subjekti Politik LVV e propozoi znj.Yllkë Fejzullahu e cila i mori 9 vota. Ndërsa nga subjekti politik PDK u propozua z.Rrahman Jakupi i cili mori 12 vota. Subjekti politik LDK nuk e propozoi asnjë kandidat. Kuvendi vendosi sipas dispozitivit të këtij vendimi.

III

Përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës janë të përcaktuara me nenin 41 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, si dhe të Udhëzimit Administrativ, Nr.2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

IV

Mandati i Kryesuesit të Kuvendit është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

V

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

VI

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Kryesuesit të zgjedhur, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i mbledhjes

Haqif Arifi

Adresa: Rr. Tiranës, Nr.50 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +381290389016, email: info@shtime-komuna.org